

PROCESVERBALI
Nga Kuvendi i dhjetë i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës,
i mbajtur me 10 tetor 2025 në Gjenevë

Prezent, anëtarët e kryesisë: Ali Mehmeti, Nasuf Nuhiu, Afërdita Krasniqi, Lutfi Rexha, Fadil Selmani, Blerim Ibrahimimi, Blerim Bunjaku, Remzi Ibrahimimi, Blerta Murtezi, Linda Rexhaj-Maliqi.

Mungojnë: Fadil Avdija, Mergime Bajrami, Premton Hajdari, Faton Haziri.

Në orën 19:30, mbledhjen e hapi kryetari i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, Z. Nasuf Nuhiu, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe u falënderua për pjesëmarrjen e tyre. Veçanërisht, ai përshëndeti përfaqësuesit dhe udhëheqsit e shoqatave prezente që veprojnë në Gjenevë, si LAPSH-in, Ansamblin "Gëzuar", FC Kosovën, Shoqatën e Studentëve dhe të tjerë.

Më tej, kryetari Nuhiu përshëndeti veçanërisht inxh. Ismet Hamitin, veprimtarin shumëvjeçar dhe anëtarin e KShGj-së që nga themelimi të cilit Nuhiu ja dha fjalën për një fjalim përshëndetës. Z. Hamiti iu drejtua të pranishmëve me fjalë miradie për aktivitetet e shoqatës sonë në dobi të komunitetit.

Kryetari Nuhiu në vazhdim, njofton të pranishmit me rëndin e ditës si në vijim:

RËNDI I DITËS

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i kaluar;
2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy Kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi;
3. Paraqitja e Bilancit financiar për vitin 2024, paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtin vitë, diskutimi dhe aprovimi;
4. Përcaktimi i anëtarëve të kryesisë pas tërheqjes apo/edhe plotësimeve me anëtarë të rinj;
5. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë;
6. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2025/2027;
7. Zgjedhja e Kryetarit-ës të KShGj-së;
8. Të ndryshme.

Pas aprovimit të rëndit të ditës njëzëri, kaluam në piken e parë.

1. Aprovimi i proces verbalit nga Kuvendi i kaluar

Procesverbali nga Kuvendi i nëntë i është dërguar të gjithë anëtarëve të KShGj-së paraprakisht përmes postës elektronike. Nuk pati asnjë vërejtje, kështu që procesverbali u aprovua njëzëri.

2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi

Kryetari Nasuf Nuhiu e falënderon sekretaren, Linda Rexhaj-Maliqi për përgatitjen e raportit të punës dhe i shpjegon në detaje aktivitetet gjatë kësaj periudhe si në vijim:

1. 50 vjetori i lagjes " LES AVANCHETS", 13 - 15 shtator 2024
2. Kermesse de Meyrin – Grupi "Hareja", 9 nëntor 2024
3. FESTA E FLAMURIT SHQIPTAR, Gjenevë me 30 nëntor 2024
4. Promovimi i veprave të Emin Azemit, 31 janar
5. Promovimi i librit "Shekulli i parë" nga Sejmen Gjokoli, "Mjeshtër i Madh" – mbajtur në Gjenevë, më 4 prill 2025
6. Stand up Comedy, 9 prill 2025
7. EPER – Sigurimet shoqërore në Zvicër, AVS-i, 11 prill 2025
8. EPER – shtylla e dytë LPP, 16 maj 2025
9. Kënga "Happy Birthday"
10. Pritja e Presidentës së Republikës së Kosovës në Gjenevë, 22 maj 2025
11. Pritja e mërgatës nga Presidentja Vjosa Osmani në Prishtinë, 31 korrik 2025
12. Festivali i 43-të në Kalabri, gusht 2025

Në vazhdim, Kryetari Nasuf Nuhiu falënderon në mënyrë të veçantë fotografën Mentor Zajmin si dhe mediat: Alb'swiss, Prointegra.ch, albinfo.ch dhe sam24.info për përcjelljen dhe publikimin e aktiviteteve të KShGj-së.

Pasi nuk pati asnjë vërejtje, raporti i punës u pranua njëzëri.

3. Paraqitja e Bilancit financiar për vitin 2024, paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtin vit, diskutimi dhe aprovim

Arkëtari, inxh. Ali Mehmeti e paraqiti Raportin financiar për vitin 2024. Pasi që nuk pati asnjë vërejtje bilanci financiar u aprovua njëzëri.

Verifikuesit e kontos për vitin 2024, të emëruar në Kuvendin e fundit, paraqitën raportin e kontrollit, të shkruar dhe nënshkruar me datën 4 tetor 2025, duke konstatuar se raporti financiar është në përputhje me Statutin e shoqatës dhe ligjin, prandaj i propozuan Kuvendit ta aprovojnë.

Nuk pati asnjë vërejtje dhe raporti i kontrollit u aprovua njëzëri.

4. Përcaktimi i anëtarëve të kryesisë pas tërheqjes apo edhe plotësimeve me anëtarë të rinj

Kryetari Nuhiu i informoi të pranishmit me keqardhje se Afërdita Krasniqi, e cila ka qenë anëtare e Kryesisë që nga themelimi i shoqatës dhe Kryetare gjatë periudhës 2018–2023, ka dhënë dorëheqje nga Kryesia, si dhe nga pozicioni i udhëheqëses së grupit muzikor "Hareja" ku kryetarin dhe kryesin e ka njoftuar me email.

Kryetari Nuhiu e falënderoi nga zemra Afërditën për angazhimin e saj të jashtëzakonshëm dhe përkushtimin e palodhur gjatë gjithë viteve. Ai theksoi se kontributi i saj ka qenë frymëzues dhe ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe afirmimin e shoqatës, duke i uruar suksese në të gjitha projektet e ardhshme. Shoqata do të mbetet gjithmonë mirënjohëse për punën e saj të përkushtuar dhe frymën e bashkëpunimit që ka sjellë dhe ja kalon fjalën Afërdita Krasniqit.

Zonja Afërdita Krasniqi i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe e konfirmoi tërheqjen e saj nga Kryesia, si dhe nga pozita e udhëheqëses së grupit muzikor "Hareja", për shkak të obligimeve familjare dhe disa pakënaqësive të kohëve të fundit.

Në fund, ajo shprehu falënderimet më të sinqerta për gjithë angazhimin e përbashkët që nga viti 2013, duke i dëshiruar Kryesisë punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësinë e punës

vullnetare. Me këtë rast, Zonja Krasniqi shprehi edhe dëshirën që shoqata Komuniteti Shqiptar të mbetet një shtëpi e ngrohtë për të gjithë ne dhe një vatër e gjallë e kulturës sonë kombëtare.

Ajo u përcoll me duartrokitjet e shumta nga të gjithë të pranishmit.

Edhe Premton Hajdari e ka njoftuar paraprakisht kryetarin dhe kryesin me email për tërheqje nga kryesia. Megjithatë, ai ka shprehur vullnetin që, sa herë që KShGj-ja të ketë nevojë, është i gatshëm të kontribuojë në mënyrë vullnetare. Kryetari Nuhiu e falënderoi shumë Premtonin për punën e tij konstruktive dhe për gatishmërinë që të vazhdojë ta mbështesë KShGj-në edhe në të ardhmen.

Në vazhdim, Kryetari Nuhiu i informoi të pranishmit se në mbledhjen e kryesisë të mbajtur më 3 tetor 2025, është njoftuar për tërheqjen e Mërgime Bajramit dhe Fadil Avdijes nga Kryesia e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës. Kryetari Nuhiu i falënderoi Fadilin dhe Mërgimen për kontributin e tyre disa vjeçar në kryesinë e KShGj-së.

Gjithashtu, Faton Haziri e ka njoftuar Kryetarin personalisht se, për shkaqe familjare, nuk mund ta vazhdojë mandatin si anëtar i kryesisë. Megjithatë, ai ka theksuar se do të jetë gjithmonë i gatshëm të ndihmojë dhe të qëndrojë në shërbim të KShGj-së. Kryetari e falënderoi Fatonin për gatishmërinë dhe përkushtimin e tij.

Kryetari Nuhiu pyeti nëse Ansambli "Gëzuar" kishte caktuar një përfaqësues tjetër në Kryesi. Me këtë rast, sekretarja e ansamblit, Zonja Mirheme Terziu, propozoi Afërdita Nuhiun si anëtare të Kryesisë nga radhët e Ansamblit "Gëzuar".

Afërdita Nuhiu u pranua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Më pas, sekretarja Linda Rexhaj-Maliqi propozoi si anëtare të re të Kryesisë Zonjën Nerxhivane Sejdiu-Ferati, e cila pranoi me kënaqësi këtë propozim, duke theksuar angazhimin e saj shumëvjeçar në aktivitete të ndryshme kulturore dhe një mandat të mëparshëm si anëtare e Kryesisë së shoqatës Komuniteti Shqiptar.

Nerxhivane Sejdiu-Ferati u pranua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Në vazhdim, Mirheme Terziu e propozon Valbona Zubaku si anëtare të Kryesisë e cila u pranua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Inxhinieri Ali Mehmeti propozoi Z. Rifat Haxhiun si anëtar të Kryesisë, duke shpjeguar se për shkak të angazhimeve profesionale ai nuk ka mundur të jetë prezent, por ka shprehur dëshirën për t'u bërë pjesë e Kryesisë. Propozimi u pranua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Xhelal Bekiri propozon që një përfaqësues i Shoqatës së Studentëve të përfshihet gjithashtu në Kryesi. Zonjusha Elda Gashi, kryetare e porsazgjedhur e Shoqatës së Studentëve, deklaroi se do ta diskutojnë në Kryesinë e tyre dhe se do të na informojnë së shpejti.

Në vazhdim, Remzi Ibrahim i propozon Qendrim Nebiun si anëtar të Kryesisë i cili me shume dëshirë e pranoi këtë propozim dhe u pranua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Kryetari Nuhiu i falënderon të gjithë anëtarët e rinj për vullnetin e tyre dhe kalon në piken nr. 5.

5. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për periudhën 2025/2027

Kryetari informon se verifikuesit për vitin 2024 kanë shprehur dëshirë që të jenë verifikues të kontos edhe për periudhën 2025/2027 dhe ky propozim u pranua nga të gjithë të pranishmit.

1. Perparim Bytyqi
2. Mirheme Terziu Ibrahim
3. Shaip Deda

6. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë

U votua njëzëri që anëtarësia të mbetet 100 fr në vit për familje. Sikurse deri tani, përjashtim bëjnë familjet që janë në asistencë sociale, personat në pension invalidë dhe studentët që janë në Gjenevë pa familje, për të cilët anëtarësia mbetet 20 fr në vit.

7. Zgjedhja e Kryetarit-ës të KShGj-së

Kryetari Nasuf Nuhiu shprehu gadishmërin dhe dëshirën për vazhdim të edhe një mandati 2 vjeçar dhe para të gjithë të pranishmëve i shpalo disa nga arritjet kryesore gjatë vitit të fundit, si dhe disa qëllime që mbeten për t'u realizuar (detajet janë të përfshira në aneksin e këtij procesverballi). Inxhinieri Ali Mehmeti sqaron se propozimi për Kryetar të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës përzgjidhet dhe votohet nga Kryesia, ndërsa në Kuvend propozohet vetëm një kandidat. Për këtë arsye, kryesia e KShGj-së propozon Nasuf Nuhiun si kandidati i vetëm për Kryetar të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës edhe për një mandat 2-vjeçar.

Nasuf Nuhiu pranohet unanimitisht si Kryetar i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës për periudhën 2025-2027.

8. Të ndryshme

Z. Ismet Hamiti ceku se do ishte mirë që faktori i biznesit në Gjenevë të ishte më prezent dhe më i zëshëm në KShGj sepse kemi shumë biznese shqiptare të suksesshëme dhe ju duhet një bashkpunim dhe kordinim më i mirë në të ardhmen.

Kryetari Nasuf Nuhiu i falënderon të gjithë pranishmit për kontributet e tyre çfarëdo qofshin ato në dobi të shoqatës dhe komunitetit tonë në përgjithësi. Punimet e Kuvendit përfunduan rreth orës 21h00 dhe në përfundim të mbrëmjes u shtrua edhe një aperitiv.

Procesverbalin e mbajti Linda Rexhaj-Maliqi